

D E K R E T
Nr.1486, datë 6.5.1996

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7679, DATË 3.3.1993 “PËR TATIMIN MBI BIZNESIN E VOGËL”

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

D E K R E T O J:

Neni 1

Neni 1 i ligjit nr.7679, datë 3.3.1993 “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, ndryshohet si vijon:

"Të gjithë personat fizikë e juridikë që kryejnë apo do të kryejnë një qarkullim më të vogël se 2 milionë lekë në një vit kalendarik dhe që nuk janë subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar, i nënshtrohen tatimit mbi biznesin e vogël, i cili llogaritet mbi të ardhurat (xhiron) e realizuara në fakt.

Qarkullimi që merret parasysh përfshin të gjitha veprimtaritë ekonomike të kryera nga i njëjti person dhe llogaritet në bazë të çmimit gjithsej që paguan blerësi.

Nëse personi fillon ose ndërpret veprimtaritë e tij ekonomike gjatë një viti kalendarik, qarkullimi në lidhje me kufirin 2 milionë lekë llogaritet në proporcionin me kohëzgjatjen e veprimtarive."

Neni 2

Në të gjithë ligjin ekzistues, pas fjalëve “personat fizikë”, shtohen kudo fjalët “e juridikë”.

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi më 1.7.1996.

KUNDËRFIRMOHET

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Aleksandër Mexsi

PRESIDENTI I REPUBLIKËS

Sali Berisha